BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3 si dhe nenin 9 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-045 për Sigurimet, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, miratoi si vijon:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR VLERËSIMIN E DËMEVE JOMATERIALE NGA AUTOPËRGJEGJËSIA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret unike të kompensimit të dëmeve jomateriale dhe dëmeve të tjera, që rrjedhin nga dëmet jomateriale si pasojë e aksidenteve të trafikut, që janë objekt i sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

2. Kjo rregullore zbatohet gjatë zgjidhjes së kërkesave për kompensim, për dëmet në aksidente të trafikut të ndodhura në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2
Përkufizime

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë siç janë përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, Ligjin nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (tani e tutje: LMD) dhe/ose siç përcaktohet më poshtë për qëllimet e kësaj rregulloreje:
   a) *Kërkuesi i kompensimit* – nënkupton të dëmtuarin, përfituesin/it, të autorizuarin e të dëmtuarit apo përfituesit/ve, si dhe përfaqësuesin/it ligjor të tyre;
   b) *Mjeku vlerësues* – nënkupton mjekun e fushës përkatëse për vlerësim të pavarur.

c) *Mjeku i siguruesit* – nënkupton mjekun në cilësinë e ekspertit të fushës përkatëse dhe çdo komision mjekësor të ngritur sipas ligjit, të cilët janë të specializuar dhe të autorizuar të bëjnë vlerësimin mjekësor të dëmeve në persona.
d) *Dëm jo material* (jopasuror, jofinanciar) - nënkupton çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore, që kanë të bëjnë me dhembjet fizike, invaliditetin jetësor, frikën, shëmtimin dhe vuajtjet psikike të anëtareve të familjes së ngushtë për personin e ndjerë apo posaçërisht rendë të lënduar.
e) *Dëm material* (pasuror, financiar) - nënkupton humbjen e pësuar nga pakësimi i pasurisë, si dhe fitimin e munguar, pra humbjen e një pasurie që i përket të dëmtuarit në çastin e shkaktimit të dëmit, si dhe pamundësinë e përfitimit të një interesi pasuror të ardhshëm (fitimi i munguar).
f) *Kompensimi i dëmit jomaterial* – nënkupton shpërblimin në të holla që ka të bëjë me dëmet jomateriale.
g) *Kompensimi i dëmit material* – nënkupton rivendosjen e gjendjes së mëparshme (përpara se të shkaktohej dëmi) dhe shpërblimin në të holla në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur. Kompensimi i dëmit material përmbledh, kompensimin për humbjen e pasurisë, si dhe fitimin e munguar apo mbajtjen e humbur si pasojë e aksidentit.
h) *Rregulla e Balthazarit* – Për të llogaritur përqindjen(%) totale të dëmtimeve në vendet anëtare të BE-së të cilat përdorin listën e dëmtimeve të llogaritura me përqindje (%), përdorin rregullin ose formulën e Baltazarit (La regle de Balthazar), e cila është e formuluar në dokumentin (B.O.B.I. - Bareme Officiel Belge des Invalidites. Vade-mecum de l evaluation medico-legal: l invaliite, l incapacite, le hendicap et le domage corporel (Pierre Feron) - Mode de calcul des invalidites multiples).
i) *ZAJ* – nënkupton zvogëlimin e aktivitetit jetësor
j) *ZAP* - nënkupton zvogëlimin e aktivitetit punues
k) *BKS* – nënkupton Byronë Kosovare të Sigurimit
l) Shtojca nr. 1- tabelat mjekësore orientuese për vlerësimin e zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në bazë të cilës përcaktohet shkalla e invaliditetit jetësor.
m) Shtojca 2- rregulla e Balthazar-it, paraqet rregullën për të llogaritur përqindjen (%) totale të dëmtimeve trupore.
n) Shtojca 3- tabela e mortalitetit paraqet modelin aktuaristik të llogaritjes së dëmeve materiale.

KREU II
KOMPENSIMI I DËMIT

Neni 3
E drejta për kompensim

1. Çdo person në cilësinë e palës së tretë, të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit motorik, që është subjekt i sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmin material dhe jomaterial për shkak të lëndimit trupor ose të vdekjes së anëtarit të familjes.

2. Kompensimi në të holla, për dëmet jomateriale dhe materiale, lind nga cenimi i integritetit psikiko-fizik (trupor), në ndonjë pjesë të trupit, me dëmtim ose humbje të ndonjë pjese të trupit, me dëmtim të përkohshëm ose të përhershëm të shëndetit.

3. Kompensimi në të holla për dëmin jomaterial do të bëhet vetëm nëse lëndimi do të vërtetohet nëpërmjet dokumenteve, ekzaminimeve dhe ekspertizave mjekësore të kryera në institucionet shëndetësore të Republikës së Kosovës ose jashtë saj.

4. Nuk do të jenë objekt i kompensimit dhembjet trupore të cilat shprehen vetëm me ankesa subjektive, pa lëndime të vërtetuara nëpërmjet ekzaminimeve mjekësore ose që nuk janë të dukshme dhe të vërtetuara nga mjeku, pasi intensiteti dhe kohëzgjatja e dhembjeve trupore nuk e arsyeton këtë kompensim për këto raste.

Neni 4
Personat që kanë të drejtë kompensimi

1. Pala e tretë – personi me të drejtë kompensimi sipas dispozitave të ligjit mbi sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, të cilit i është shkaktuar dëm apo lëndim nga mjeti motorik.

2. Anëtarët e familjes së ngushtë (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit), në rast vdekjeje të bashkëfamiljarit.

3. Për kompensimin e dhembjes shpirtërore vëllezërit dhe motrat, në rast të vdekjes së vëllezërve dhe motrave, në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme deri në datën e aksidentit.

4. Bashkëshortët, fëmijët dhe prindërit, në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të anëtarit të familjes për dhembjet e tyre shpirtërore.

5. Shpërblimi nga paragrafi 2 dhe 4 i këtij neni mund t`i caktohet edhe bashkëshortit jashtë martesor në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, ose personit të lënduar ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme deri në momentin e aksidentit.

6. Të drejtën e kompensimit të dëmit e ka edhe personi që ka pësuar humbjen e ushqimit ose të ndihmës nga personi i vdekur si pasojë e aksidentit të trafikut, i cili e ka ushqyer ose ndihmuar rregullisht, si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja.

7. Fëmijët nën moshën e punës (18 vjet), ndërsa kur fëmijët vazhdojnë studimet e rregullta vijojnë ta përfitojnë mbajtjen e humbur deri në përfundim të studimeve por jo më larg se deri në moshën 24 vjeç, duke e vërtetuar me dokumentacion vazhdimin e shkollimit.

Neni 5
Vlerat e kompensimit dhe qëllimi i tyre

1. Vlerat e kompensimit kanë për qëllim ta rivendosin gjendjen e të dëmtuarit e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi;

2. Nëse nuk mund të rivendoset plotësisht gjendja e mëparshme, ose nuk mënjanohet plotësisht dëmi, jepet kompensim në të holla për të dëmtuarit dhe për familjarët e tyre;

3. Caktimi i kompensimit me të holla për format e dëmit jomaterial ka për qëllim që t'ua bëjë të mundshme të lënduarit dhe përfituesve të tjerë, që të sigurojnë satisfaksion të duhur shpirtëror si kundërpeshë e dhembjeve fizike dhe shpirtërore për dëmin e pësuar;

4. Pagesa e kompensimit për dëmin jomaterial (jofinanciar) dhe lartësia e tij nuk duhet të cenojnë të mirën dhe qëllimin për të cilin shërben ky kompensim, si dhe nëpërmjet tij nuk duhet të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e kompensimit.

5. Vlera e kompensimit për dëmin jomaterial për personin fizik të lënduar në aksidentin e trafikut caktohet në bazë të vlerësimit nga ekspertët mjekësorë kompetentë (censorët).

6. Lartësia e kompensimit do të jetë në pajtim me dëmin, dhembjen e përjetuar dhe do të përjetohet në të ardhmen për shkak të pasojave të aksidentit.

Neni 6
Përgjegjësia e ndarë

1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në kompensimin përpjesëtimisht të pakësuar.

2. Në rast të ndarjes së përgjegjësisë, siguruesi është i obliguar që ndarjen e përgjegjësisë për kontributin në aksident ta bëjë në bazë të rrethanave të rastit.

3. Për rastet e përgjegjësisë solidare, kur përgjegjësia ndahet ndërmjet disa siguruesve ose BKS-së, pala e dëmtuar kompensohet plotësisht nga siguruesi apo BKS-ja, varësisht ku është paraqitur kërkesa.

4. Kur siguruesit përgjegjës ose BKS-ja nuk bien dakord me marrëveshje për ndarjen e përgjegjësisë, ose nuk ka vendim të gjykatës për ndarjen e saj, ato do të përgjigjen në mënyrë të barabartë apo në bazë të ekspertizës profesionale të pavarur. Siguruesit përgjegjës dhe BKS-ja duhet të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën sa herë mendojnë për përgjegjësi të ndarë, duke lajmëruar për pjesën e pranuar të përgjegjësisë.

Neni 7
Regresi i paguesit

1. Siguruesit të cilët paguajnë më tepër se sa është shuma e pjesës së saj në dëmin e shkaktuar, kanë të drejtë të kërkojnë nga siguruesit tjerë që t`ia kompensojnë dëmin që është paguar në emër të tyre.

2. Lartësia e pjesës së secilit sigurues përgjegjës ose BKS, veç e veç caktohet me marrëveshje mes tyre. Kur kjo nuk është e mundur, atë e cakton gjykata, duke marrë parasysh peshën e fajësisë të secilit drejtues të mjetit motorik të përfshirë në aksident.

KREU III
RREGULLAT PËR VLERËSIMIN MJEKËSOR

Neni 8
Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të personit të lënduar

1. Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të personit të lënduar bëhet nga mjeku i fushës përkatëse, i cili përcakton:

a) Zvogëlimin e aktivitetit jetësor, si dhe zvogëlimin e aktivitetit punues, duke përcaktuar përqindjen (shkallën) e humbjes së aftësisë së përhershme për punë, të pjesshme ose të përgjithshme;
b) Afatin e paaftësisë së përkohshme për punë;
c) Intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve trupore;
d) Intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës;
e) Shkallën e shëmtimit;
f) Nevojën për shpenzimet mjekësore për trajtim dhe medikamente mjekësore;
g) Nevojën për kujdesin e huaj (të një personi të tretë) dhe kohëzgjatjen e tij;
h) Nevojën për ushqim të përforcuar dhe kohëzgjatjen e tij;
i) Nevojën për ekzaminime shtesë si dhe vlerësimin e gjendjes nga specialistë mjekësorë të tjerë.

Neni 9
Ekspertiza mjekësore

1. Kryerja e ekspertizës mjekësore, duhet të bëhet nga mjeku ekspert - specialisti i fushës përkatëse mjekësore në varësi nga natyra e lëndimit.

2. Për rastet me lëndime të rënda trupore apo me shëmtim trupor është i detyrueshëm ekzaminimi i drejtpërdrejtë i palës së dëmtuar.

3. Mjeku është i detyruar që diagnozat në gjuhën latine t`i përkthejë dhe t'i përshtatë në gjuhën zyrtare.

Neni 10
Caktimi i zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor

1. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor i të dëmtuarit përfshin të gjitha kufizimet e aktiviteteve jetësore të cilat i ka realizuar ose të cilat sipas rrjedhës së rregullt të gjërave edhe në të ardhmen sigurisht do t'i realizonte.

2. Caktimi i zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, bëhet bazuar në *"Tabelat e përcaktimit të përqindjes së zvogëlimit të aktivitetit jetësor"* që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje (shtojca 1).

3. Përqindja konstatohet në bazë të dokumentacionit origjinal mjekësor, që e paraqet i lënduari bashkë me kërkesën, pas përfundimit të mjekimit për lëndimet e marra në aksidentin e trafikut.

4. Përqindja e ZAJ caktohet pas mjekimit të kryer, për gjendje për të cilat sipas parashikimit mjekësor nuk mund të pritet se do të përmirësohet ose të keqësohet, kurse më së voni derisa të kalojnë 3 vjet nga dita kur ka ndodhur aksidenti në trafik.

5. Te lëndimet e shumëfishta të disa pjesëve të trupit (të gjymtyrëve, të kurrizit ose të organeve) përqindja e tërësishme e ZAJ në pjesën e caktuar të trupit (në gjymtyrë, kurriz ose organe), caktohet në atë mënyrë që për pasojën më të madhe të dëmtimit merret përqindja e plotë e paraparë në ***"tabela e përcaktimit të përqindjes së zvogëlimit të aktivitetit jetësor"***, e bazuar në rregullën e Balthazarit (Shtojca 2).

6. Përqindja e tërësishme nuk mund ta kalojë përqindjen e përcaktuar në *"tabela e përcaktimit të përqindjes së aktivitetit jetësor"* për humbje të plotë të asaj pjese të trupit, përkatësisht të atij organi.

7. Përqindjet e dëmtimit të gishtave mblidhen (nuk zbatohet Rregulla e Balthazarit) duke bërë matje të detyrueshme krahasuese me artrometër (këndmatës).

8. Në qoftë se kemi të bëjmë me lëndimin e gjurit aplikohen tabelat sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, por në atë mënyrë që shuma e tërësishme e përqindjes për dëmtimin e caktuar nuk mund ta kalojë përqindjen prej 30%.

9. Caktimi i pasojave nga lëndimet e pësuara, për një pasojë në organin e njëjtë ose në ekstremitetin e njëjtë, zbatohet vetëm një pikë, e cila përcakton përqindjen më të lartë sipas tabelës (shtojca 1).

Neni 11
Përcaktimi i shkallës së zvogëlimit të aftësisë punuese

1. Përcaktimi i shkallës së zvogëlimit të aftësisë punuese (invaliditeti), përcaktohet në bazë të tabelave Shtojca 1 dhe Shtojca 2, pas përfundimit të mjekimit.

2. Përllogaritja e ZAP (invaliditeti), bëhet vetëm në rastet kur shkalla e zvogëlimit të aktivitetit jetësor është mbi 30%, e konstatuar nga mjeku.

3. ZAP i përkohshëm duhet të llogaritet për vitin e parë pas aksidentit, eventualisht për vitin e dytë deri në të pestin pas aksidentit, me kusht që pas pesë vitesh të bëhet riekzaminimi i palës së dëmtuar dhe rivlerësimi lidhur me zvogëlimin e aktivitetit të përhershëm punues eventual. Nga ky nen (rregull) bëjnë përjashtim dëmtimet e matshme, të përhershme, të paripërueshme siç janë: amputimet, humbja e organeve (veshka, shpretka, syri) etj.

4. Kur aftësia e përgjithshme për punë, te personi i lënduar ka qenë e përhershme para se të ndodhnin lëndimet në aksident trafiku, përqindja e humbjes së aftësisë së përgjithshme për punë, caktohet sipas pasojave të lëndimit të ndodhur rishtazi, pavarësisht nga ato të mëparshme, me përjashtim nëse:
   a) lëndimet e pësuara kanë shkaktuar rritjen e invaliditetit të deriatëhershëm, përqindja e humbjes konstatohet si dallim ndërmjet përqindjes së tërësishme, të cilën e ka kushtëzuar lëndimi i ri dhe përqindjes që të lënduarit i ka takuar për lëndimin e mëparshëm;
   b) lëndimet e pësuara kanë shkaktuar humbje ose lëndime të pjesëve të trupit ose të ndonjë organi paraprakisht të lënduar – përqindja konstatohet vetëm për shkallën e pasojave të reja.

Neni 12
Përjashtime dhe përgjegjësitë

1. Lëndimet trupore të pësuara, të cilat vërtetohen nga mjeku, nëse janë pasojë e mosmbajtjes së rripit të sigurisë apo helmetës së kokës gjatë qarkullimit me motoçikletë dhe të gjitha masave të tjera sipas Ligjit mbi sigurinë në komunikacion, mund të trajtohen me bashkëpërgjegjësi.

2. Shkathtësitë individuale, pozita shoqërore, hobi i të dëmtuarit, nuk merren për bazë gjatë përcaktimit të invaliditetit.

3. Dokumentacioni mjekësor i prezantuar nga ana e të dëmtuarit, duhet të ketë raportin e emergjencës ose institucionit shëndetësor të licencuar, brenda 24 orëve nga ndodhja e aksidentit, raportet e tjera eventuale bashkë me dokumentacionin mjekësor duhet të jenë të firmosura, të vulosura dhe të protokolluara nga institucionet shëndetësore të licencuara.

4. Raportet mjekësore pa diagnoza, pa përshkrime të lëndimeve apo vetëm me përshkrim të ankesave subjektive, nuk duhet të merren për bazë vlerësimin, me përjashtim të frikës.

KREU IV
DËMI MATERIAL

Neni 13
Dëmi material dhe format e tij

1. Dëmi material (dëmi financiar) ka si pasojë cenimin e pasurisë së të dëmtuarit në kuptimin e ngushtë ekonomik, pra humbjen ose pakësimin e pasurisë nga aksidenti i ndodhur.

2. Dëmi material nënkupton humbjen e pësuar nga zvogëlimi i pasurisë, si dhe fitimin e munguar si pasojë e aksidentit. Në rastin e parë objekt i dëmit është pakësimi, humbja e një interesi pasuror aktual, pra e një pasurie që i përket të dëmtuarit në çastin e shkaktimit të dëmit. Në rastin e fitimit të munguar kemi të bëjmë me pamundësinë e përfitimit të një interesi pasuror të ardhshëm, pra të një pasurie që ende nuk i përket të dëmtuarit në çastin e shkaktimit të dëmit.

3. Format e dëmit material, mbi bazën e të cilave jepet kompensim janë:
   a) Mbajtja e humbur e anëtarëve të familjes, në rastet e vdekjes së bashkëfamiljarit
   b) Humbja e fitimit për shkak të paaftësisë së përhershme, të plotë ose të pjesshme për punë të të lënduarit.
   c) Fitimi i munguar për shkak paaftësisë së përkohshme për punë;
   d) Shpenzimet e mjekimit dhe të rehabilitimit;
   e) Shpenzimet për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë;
   f) Dëmtimi i sendeve që përdoren për nevoja personale, rrobat etj;
   g) Shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores mbivarrore;

Neni 14
Mbajtja e humbur dhe fitimi i humbur

1. Mbajtja e humbur për shkak të vdekjes së bashkëfamiljarit nënkupton të drejtën e kompensimit në lidhje me dëmin pasuror të pësuar në formën e fitimit të munguar, si një pamundësi për të përfituar, në rrjedhën normale të jetës, solidaritetin dhe kontributin e të ndjerit, jo vetëm si përkujdesje në tërësi, por edhe si mbështetje ekonomike e tij për familjen në të ardhmen.

2. Mbajtja e humbur e anëtarëve të familjes kompensohet nëpërmjet pagesës së rentës mujore (pagesës mbi baza mujore) të vlerës që do të përfitohej në çdo muaj nëse vdekja nuk do të kishte ndodhur, ose të pagesës së përnjëhershme të të gjitha rentave të ardhshme (vlera e tashme e pritshme e tyre, duke marr për bazë tabelat e mortalitetit dhe normën e interesit për të diskontuar pagesat e ardhshme). Mbajtja e humbur merr në konsiderim kontributin financiar në familje të të ndjerit nëse do të vazhdonte të ishte gjallë deri në moshën e daljes në pension dhe për aq kohë sa për bashkëfamiljarët do të ekzistonin kushtet ligjore;

3. Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë humbur ose janë pakësuar, siguruesi përgjegjës ose BKS-ja ka për detyrë t`i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm.

4. Humbja e fitimit duhet të provohet me dokumentacion nga personi i lënduar dhe do të kompensohet kur provohet se lëndimi ka pasoja që shprehen me zvogëlim të aktivitetit punues (invaliditetit), të përhershëm ose të përkohshëm, si dhe për rastet e vërtetuara të paaftësisë së përkohshme për punë. Për rastet kur personi i lënduar vijon punën normalisht dhe nuk ka humbje të të ardhurave (të fitimit) sipas rrjedhës normale të jetës, pra kur merr pagën si më parë, ose vazhdon të njëjtat veprimtari punuese e jetësore nuk llogaritet humbje e fitimit. Personat e papunësuar në momentin e aksidentit duhet të provojnë se ata nuk mund të kryejnë veprimtaritë jetësore e punuese si më parë dhe pagesa do të ndërpritet nëse ata fillojnë punë;

5. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmarrë veprimin.

6. Kompensimi i mbajtjes së humbur ose fitimit të munguar, në formën e rentës mujore në të holla, si rregull, paguhet në fillim të çdo muaji.

7. Në marrëveshje me përfituesit/ të dëmtuarit, në vend të pagesës së rentës mujore mund të paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilës do të caktohet sipas lartësisë së rentës mujore dhe kohëzgjatjes së mundshme me përjashtim të kushteve ligjore të përfituesit/të dëmtuarit, me zbritje të kamatave (diskontimin) përkatëse, sipas metodologjisë së përcaktuar më poshtë në këtë rregullore.

8. Vlera e llogaritur e mbajtjes së humbur, në formë të rentës mujore ose të pagesës së menjëhershme (kapitalizuar), nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetej gjallë.

Neni 15
Llogaritja e mbajtjes së humbur

1. Mbajtja e humbur e anëtarëve të familjes, ose shprehur ndryshe renta, në rast të vdekjes së bashkëfamiljarit, kompensohet në formën e pagesës mujore ose në formën e pagesës së një shume të përgjithshme në formë të menjëhershme (kapitalizuar) sipas marrëveshjes së palëve.

   Mbajtja e humbur mbi bazë të pagesës mujore **(renta mujore)** llogaritet duke zbritur nga të ardhurat personale mujore neto të të ndjerit vlerën për vetëmbajtjen e tij. Vlera që rezulton pas zbritjes nga të ardhurat personale neto, të vlerës për vlerën e vetëmbajtjes së të ndjerit do të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë përfituesit që kanë të drejtë për mbajtjen e

humbur. Ajo do të paguhet për aq kohë sa ekzistojnë kushtet ligjore për secilin prej tyre, që nënkupton periudhën deri kur përfituesit kanë të drejtë ligjore, por jo edhe pas datës kur mbajtësi i ndjerë në kushte normale do të pensionohej.

2. Mbajtja e humbur (renta) në formë të pagesës së përnjëhershme do të përllogaritet si vlerë e tashme e rentave (të ardhshme) të pritshme duke i diskontuar me normë të interesit që do t'i referohet normës së obligacioneve afatgjate qeveritare (5 vjet apo më shumë) apo normës së kthimit në investime të ngjashme afatgjate. Vlera e pritshme e pjesës së rentave që i takon secilit person përfitues do të llogaritet duke përdorur tabelat e mortalitetit që janë pjesë e kësaj rregulloreje e prezantuar në shtojcën 3.

3. Në rast të diskontimit të periudhave më të shkurta se 5 vite, për normë të interesit mund të merren normat e afatizimit të depozitave në bankat vendore, varësisht se si e vlerëson këtë aktuari apo eksperti që bën llogaritjen e tillë.

4. Modeli i llogaritjes së vlerës së përnjëhershëm do të përbëhet nga shuma e llogaritjeve individuale për secilin përfitues nga mbajtja e humbur (gjersa për të ekzistojnë kushtet ligjore)

$$PM = \sum_{j=1}^{m} PM_j \ , \qquad m - \textit{numri i perfituesve te mbajtjes se humbur}$$

PM
$- \textit{Pagesa e menjehershem e rentave te ardheshme per te gjithe perfituesit e mbajtjes se humbur}$

$$PM_j = \sum_{k=1}^{n} \frac{PR_k}{(1+i)^k} \ ,$$

$n - \textit{numri i viteve deri kur perfituesit j}$
$- \textit{te te mbajtjes se humbur do ti takoj pjesa e tij e rentes}$

$PR_k - \textit{Vlera e pritshme e pjeses se rentes vjetore ne vitin k, qe do ti takoj perfituesit j} - \textit{te}$
$i - \textit{Norma e interesit, (siq u specifikua te pikat 3. dhe 4.)}$

5. Nga dita e aksidentit deri në ditën e llogaritjes së mbajtjes së humbur vlera e saj llogaritet në total, si shumë e kapitalizuar (duke përfshirë edhe kamatën sipas arritjeve mujore për pagesë) e vlerës së të ardhurave mujore që do të realizoheshin duke zbritur vlerën e vet mbajtjes së personit të ndjerë të ardhurave për nevojat e vet personit që nuk jeton më.

Neni 16
Diferencat midis kohës së llogaritjes dhe kohës së aksidentit

Kur llogaritja e mbajtjes së humbur bëhet në një periudhë më të largët se 6 muaj nga dita e aksidentit, llogaritja nga dita e aksidentit deri në ditën e llogaritjes bëhet si shumë e thjeshtë e fitimit të munguar apo mbajtjes së humbur për këtë periudhë duke llogaritur të ardhurat e parealizuara për shkak të pasojave të lëndimit ose të vdekjes, në të njëjtën mënyrë siç llogaritet renta mujore. Llogaritja në formë të përnjëhershme bëhet nga dita e llogaritjes (ofertës) e më pas.

Neni 17
Të ardhurat personale

1. Për vlerësimin e të ardhurave personale merret në konsiderim e ardhura neto që do t'i realizonte i ndjeri ne rast te mbajtjes se humbur, ndërsa te ardhurat neto plus kontributet pensionale për rastin e fitimit të munguar.

2. Për rastet kur i dëmtuari ka pasur marrëdhënie të rregullta pune, të ardhurat e realizuara konsiderohen të ardhurat mesatare neto gjatë 12 muajve të fundit në vitin e fundit para se të aksidentohet para ditës së aksidentit. Vërtetimi për të ardhurat lëshohet nga punëdhënësi dhe duhet të konfirmohet nga Trusti Pensional, ATK-ja apo ndonjë institucion tjetër kompetent.

3. Për rastet kur i dëmtuari ka qenë i vetëpunësuar, për rastet e biznesit privat (pronar), të ardhurat personale do të konsiderohen të ardhurat mujore nga ai biznes neto për rastin e mbajtjes së humbur dhe të ardhurat neto plus kontributet pensionale për fitimin e humbur llogariten si mesatare për tre vitet afariste. Vërtetimi për të ardhurat do të konfirmohet nga ATK, Trusti Pensional apo ndonjë institucion tjetër kompetent.

4. Për rastet e të dëmtuarve që nuk kanë qenë të punësuar të ardhura do të konsiderohen:
   a) për personat e dëmtuar të moshës madhore deri në 35 vjeç dhe që nuk kanë kualifikim, të vërtetuar me dokumentacion, të ardhura do të konsiderohen mesatarja e të ardhurave të një punonjësi të pakualifikuar sipas të dhënave zyrtare të Agjensionit të Statistikave të Kosovës apo burimeve të tjera shtetërore.
   b) për personat e dëmtuar të moshës mbi 35 vjet dhe që nuk kanë kualifikim, të vërtetuar me dokumentacion, të ardhura do të konsiderohen ato sipas pagës minimale zyrtare të miratuar nga organi shtetërore.
   c) për personat e dëmtuar qe kane kualifikim, të vërtetuar me dokumentacion, të ardhura do të konsiderohen mesatarja e të ardhurave të një punonjësi të të njëjtit kualifikim sipas të dhënave zyrtare të Agjensionit të Statistikave të Kosovës apo burimeve të tjera shtetërore.

5. Për rastet e të dëmtuarve që merren me aktivitete private bujqësie e blegtorie etj dhe që janë deklaruar si të vetëpunësuar, të ardhura do të konsiderohen të ardhurat e deklaruara nga vetëpunësimi, e në mungesë të deklarimit të tyre do të merret në konsideratë pika 4 e këtij neni.

6. Për rastet e të dëmtuarve që janë të punësuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës, të ardhura personale do të konsiderohen të ardhurat neto nga paga e punës për vitin e fundit të cilat duhet të vërtetohen nga certifikata e lëshuar për këtë qëllim nga punëdhënësi, e konfirmuar nga organet kompetente të vendit përkatës. Për vetëmbajtjen e të ndjerit në këtë rast nuk veprohet si në rastet e vdekjeve në Kosovë, por merret për bazë kostoja e jetës ku ka qëndruar dhe punuar i ndjeri.

7. Për rastet e personave të dëmtuar që në momentin e aksidentit nuk kanë mbushur moshën e punës për të aksidentuarit me pasoja invaliditeti punues, por që në momentin e aksidentit nuk e kanë moshën madhore, për ta llogaritet fitimi i humbur pas arritjes së moshës madhore kur dhe eksperti mjekësor kompetent do ta vlerësojë shkallën e invaliditetit të tij punues.

8. Për personat e dëmtuar që janë në pension në momentin e aksidentimit, të ardhura personale do të konsiderohen shuma e pensionit që ka marrë vitin e fundit përpara aksidentit, për rastin e mbajtjes së humbur.

Neni 18
Ndarja e fitimit të munguar

1. Përqindja e të ardhurave për nevojat e vetë personit do të llogaritet proporcionalisht në varësi të numrit të bashkëjetuesve (bashkëfamiljarëve) me të ndjerin përpara aksidentit dhe do të jetë si më poshtë:

2. Kur i ndjeri ka qenë i vetëm në familje të ardhurat konsiderohen 100% për nevojat e vet personit. Në këto raste nuk do të paguhet mbajtje e humbur (rentë), por do të paguhen vetëm shpenzimet e varrimit. Këto shpenzime i paguhen subjektit që ka kryer shërbimet funerale ose shtetit;

3. Në varësi nga numri i bashkëjetuesve, që kanë të drejtë për mbajtjen e humbur, përqindja e nevojave për nevojat e vet personit të ndjerë do të llogaritet në mënyrë proporcionale për numrin e bashkëjetuesve dhe do të jetë 1/n*100%, ku n është numri i bashkëjetuesve përpara aksidentit:
   a) për një bashkëjetues (pa të ndjerin).....50%;

b) për dy bashkëjetues (pa të ndjerin).....33%;
c) Për më shumë bashkëjetues llogaritja bëhet në të njëjtën mënyrë duke llogaritur pjesën proporcionale që do t'i takonte të ndjerit.

Neni 19
Humbja e fitimit për shkak të paaftësisë së përhershme (invaliditetit)

1. Humbja e fitimit për shkak të paaftësisë së përhershme, të plotë ose të pjesshme, llogaritet në formë të pagesës mujore (rentës mujore) dhe në formë të përnjëhershme.

2. Përllogaritja e fitimit të humbur në formë të pagesës mujore **(rentës mujore)** llogaritet si produkt i të ardhurave personale mujore me përqindjen e humbjes së aftësisë për punë (invaliditetit), sipas formulës së mëposhtme:

   Rm = Tapm x Khap

   Rm Renta mujore
   Tapm Të ardhurat personale mujore
   Khap % e zvogëlimit të aktivitetit punues, (koeficienti i humbjes së aftësisë për punë, ose invaliditeti)

3. Përllogaritja e fitimit të humbur **në formë të përnjëhershme** bëhet në mënyrë të njëjtë duke llogaritur vlerën e tashme të pritshme të fitimit në përpjesëtim me zvogëlimin e paaftësisë.

4. Pagesa mbi baza mujore e fitimit të munguar bëhet deri në vitin e moshës së daljes në pension.

Neni 20
Fitimi i humbur për shkak paaftësisë së përkohshme për punë

1. Fitimi i humbur për shkak të paaftësisë së përkohshme për punë llogaritet bazuar në periudhën e paaftësisë dhe të ardhurave personale neto plus kontributet pensionale mujore;

2. Përllogaritja e fitimit të munguar për shkak të paaftësisë bëhet për të gjithë periudhën e caktuar nga mjeku ose komisioni mjekësor;

3. Kur i dëmtuari është pa punë, kompensimi llogaritet duke konsideruar përcaktimin e të ardhurave sipas nenit 18, llogaritur për të gjithë periudhën e paaftësisë.

4. Nëse paaftësia e përkohshme për punë është e pjesshme, fitimi i munguar llogaritet në mungesën e të punësuarit në punë.

5. Fitimi i munguar për paaftësi të përkohshme mund të paguhet mbi baza mujore ose në formë të përmenjëhershme (kapitalizuar).

Neni 21
Të ardhurat personale dhe koeficientet e përdorur në llogaritje

Koeficienti i humbjes së aftësisë për punë (*Khap*) jepet nga mjeku censor dhe/ose Komisioni Mjekësor duke u mbështetur në *"Tabela e përcaktimit të përqindjes së zvogëlimit të aktivitetit punues, respektivisht zvogëlimit të aktivitetit jetësor"* bashkangjitur kësaj rregulloreje të referuara si shtojca 1 dhe 2;

Neni 22
Ndryshimi i shpërblimit të vlerësuar për fitimin e humbur

1. I siguruari përgjegjës ose BKS-ja mund të bëjë auditimin e shkresave të lëndës së fitimit të munguar (rentës) në bazë të të cilave bën pagesën.

2. Siguruesit ose BKS-ja do të njoftojë personin që i paguan fitimin e humbur (rentën) mujore nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i rëndësishëm i rrethanave në raport me rrethanat që ishin në kohën kur është caktuar renta mujore, si dhe do të ndërmarrë veprimet e nevojshme juridike me qëllim të zvogëlimit apo ndërprerjes së rentës në qoftë se provon se kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat në bazë të së cilave është llogaritur renta mujore.

Neni 23
Raste të veçanta për fitimin e humbur

1. Për lëndimet trupore me paaftësi për personat nën moshën 18 vjeç nuk pranohet kompensim për fitimin e humbur (rentën), por pranohet pagesa për kujdesin e personit të huaj (personit të tretë) për aq kohë sa përcaktohet nga mjeku. Kurse e drejta në rentë të formës së fitimit të humbur do t'i njihet pas arritjes së moshës madhore dhe nëse për atë do përmbushen kushtet ligjore.

2. Fitimi i humbur njihet edhe për personat mbi 16 vjeç kur personat në momentin e aksidentit kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale me një punëdhënës.

3. Në rastet kur personi i aksidentuar është 15 vjet e më lartë dhe kur prezantohen dokumente valide të kontratës së punës, kjo rrethanë duhet të merret parasysh në llogaritjen e fitimit të humbur.

Neni 24
Shpenzimet e mjekimit dhe të rehabilitimit

1. Shpenzimet e mjekimit dhe të rehabilitimit përfshijnë të gjitha shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme të mjekimit të personit të lënduar në aksidentin e trafikut, me qëllim që të përmirësohet gjendja shëndetësore e atij personi, në qoftë se nuk janë mbuluar me ndonjërën nga format e mbrojtjes shëndetësore të detyrueshme ose vullnetare. Lidhur me këtë, i aksidentuari duhet të deklarohet me shkrim para se të realizojë kompensimin, për shkak të kërkesave të mundshme të personave të tretë (institucioneve shëndetësore brenda e jashtë Republikës së Kosovës, Fondeve Pensionale dhe Invalidore brenda e jashtë Republikës së Kosovës e institucione të tjera që kanë parapaguar për dëmin që rrjedh nga ky rast.

2. Kompensimi caktohet edhe për shpenzimet e rehabilitimit fiziko - psikik, mjekimit në banja klimatike, ftizioterapi etj., kur kjo rezulton si e domosdoshme nga dokumentacioni mjekësor me qëllim të rritjes së aftësisë së përgjithshme për punë, përkatësisht të aktivitetit jetësor për çka duhet të deklarohet mjeku, në qoftë se i lënduari nuk i përfiton ato sipas ndonjë bazë tjetër, për çka është i detyruar të deklarohet me shkrim dhe ta bashkëngjisë llogarinë valide për pagesën e atyre shpenzimeve.

3. Kompensimi për shpenzimet e mjekimit paguhen sipas recetës së mjekut dhe faturave fiskale të konfirmuara nga mjeku i siguruesit pasi të konfirmohen si shpenzime që i përkasin lëndimit.

4. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë fonde në formë të paradhënies (akontacionit) për shërim apo trajtim mjekësor. Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe të jepet përgjigja me shkrim brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për akontacion.

5. Pas konfirmimit të komisionit trajtues lidhur me aprovimin e kërkesës për paradhënie, siguruesi në afat brenda 2 (dy) ditësh duhet të alokojë fondet në llogarinë personale të palës së dëmtuar, të autorizuarit apo institucionit shëndetësor ku pala e dëmtuar nevojitet të kryejë operacionin apo shërimin.

Neni 25
Vlerësimi i shpenzimeve për trajtim mjekësor jashtë territorit të Republikës së Kosovës

1. Miratimi për trajtim mjekësor jashtë territorit të Kosovës bëhet nga siguruesit, pasi të analizohet kërkesa e të lënduarit dhe rekomandimi mjekësor nga Komisioni i QKUK-së në Prishtinë përpos rasteve akute kur ky rekomandim nuk mund të sigurohet me kohë.

2. Komisioni mjekësor i QKUK-së duhet të përcaktojë ndërhyrjet (operacionet) që do të kryhen dhe numrin e tyre.

3. Miratimi bëhet vetëm për rastet e trajtimit të specializuar që nuk ka mundësi të bëhet në klinikat dhe spitalet private e shtetërore në territorin e Republikës së Kosovës.

4. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë fonde në formë të paradhënies (akontacionit) për shërim apo trajtim mjekësor. Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe të jepet përgjigja me shkrim brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për akontacion.

5. Pas konfirmimit të komisionit trajtues lidhur me aprovimin e kërkesës për paradhënie, siguruesi në afatin brenda dy ditëve duhet të alokojë mjetet financiare në llogarinë personale të palës së dëmtuar, të autorizuarit apo institucionit shëndetësor ku pala e dëmtuar nevojitet të kryejë operacionin apo trajtimin mjekësor.

Neni 26
Kompensimi për kujdesin dhe ndihmën e huaj

1. Kompensimi i ndihmës dhe kujdesit të huaj caktohet në përputhje me dispozitat nga fusha e sigurimit pensional e invalidor, përkatësisht të dispozitave për mbrojtje shëndetësore dhe sociale.

2. Ndihmë dhe kujdes i huaj, sipas kuptimit të kësaj rregulloreje nënkuptohen shërbimet që i ofrohen personit fizik të aksidentuar, që ia mundësojnë plotësimin e nevojave themelore biologjike, siç janë: marrja e ushqimit, veshja dhe zhveshja, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, lëvizjet me mjete ndihmëse ose edhe pa to, në qoftë se këto nevoja nuk mund t'i plotësojë vetë për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme.

3. Nevojën për kujdes dhe ndihmë të huaj e cakton mjeku censor apo mjeku në cilësinë e ekspertit në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe/ose ekzaminimit të drejtpërdrejtë të personit të lënduar.

4. Kompensimi për ndihmën dhe kujdesin e huaj përcaktohet në bazë të kohëzgjatjes dhe të llojit (vëllimit) të ndihmës, si më poshtë:
   a) **për ndihmën dhe kujdesin e huaj - të përkohshme dhe të pjesshme** – kur të dëmtuarit i nevojitet ndihma e huaj pjesërisht për përmbushjen e një pjese të nevojave jetësore dhe kjo i duhet kohë pas kohe, shuma e kompensimit duhet të jetë në përputhje me vlerën për ofrimin e shërbimeve të atilla në mjedisin konkret. Shuma e kompensimit nuk duhet të jetë më e lartë se kompensimi, i cili për shërbime të njëjta,

mund të realizohet sipas dispozitave për mbrojtje shëndetësore dhe sociale ose sipas dispozitave të sigurimit pensional dhe invalidor.

b) **për ndihmën dhe kujdesin e huaj - të përhershëm dhe të pjesshëm -** ky kompensim (dëmshpërblim) caktohet në përputhje me vëllimin e ndihmës së huaj që duhet t'i bëhet të dëmtuarit, si edhe të elementeve të tjera, me të cilat përcaktohet vlera e punës së personit të tretë, pra vlera për ndihmën që shfrytëzohet.

c) **Për kujdesin dhe ndihmën e huaj - të plotë e të përkohshme -** kompensimi caktohet në lartësinë e shumës, që në raste të këtilla e paguan Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor. Në raste të tjera shuma e kompensimit ditor për ndihmën e huaj caktohet si shumë e kompensimit për punët e ofrimit të ndihmës në shtëpi në lartësinë e kompensimit për atë lloj të shërbimeve në mjedisin konkret. Kjo shumë caktohet në bazë të treguesve të mirëfilltë statistikorë të kohës kur paraqitet nevoja për ndihmë dhe kujdes të huaj.

d) **Për ndihmën e kujdesin e huaj - të plotë e të përhershëm** – kur kemi të bëjmë për ndihmë të plotë e të përhershme, sidomos te format e invaliditetit të rëndë, kompensimi caktohet në shumën e të ardhurave mesatare mujore të punëtorit shëndetësor të profesionit përkatës. Ky kompensim pranohet vetëm në qoftë se i lënduari nuk e ka realizuar sipas ndonjë baze tjetër, për çka është i detyruar të deklarohet me shkrim para se t'i lejohet kompensimi.

5. Lartësia e kompensimit të plotë për ndihmën dhe kujdesin e huaj nuk mund të kalojë lartësinë e të ardhurave mesatare mujore të personit të profesionit mjekësor, që e kryen këtë lloj pune.

6. Kur shpenzimet për ndihmën dhe kujdesin e huaj paguhen sipas bazës së sigurimit pensional dhe invalidor, ose sipas dispozitave për mbrojtje shëndetësore dhe sociale, ose sipas ndonjë baze tjetër të ngjashme, ato nuk do t'i paguhen personit të dëmtuar.

7. Pala e dëmtuar duhet të vërtetojë që ka nevojë për ndihmën e huaj, si dhe të vërtetojë atë me prova materiale.

Neni 27
Ushqimi i përforcuar

1. I dëmtuari ka të drejtë për ushqim të përforcuar gjatë kohës së mjekimit.

2. Kompensimi në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar pranohet varësisht nga natyra e lëndimit dhe kohëzgjatja.

3. Kohëzgjatjen për ushqim të përforcuar për personin e lënduar e cakton mjeku censor. Ndërsa shpërblimi mujor për ushqimin e përforcuar pranohet deri në lartësinë prej dyqind e dhjetë (210) euro (7 euro në ditë).

Neni 28
Kompensimi për dëmtimin e sendeve që përdoren për nevoja personale

1. Kompensimi për veshmbathjet e dëmtuara caktohet sipas çmimit të sendeve të njëjta të veshmbathjeve në ditën e ndodhjes së dëmit.

2. Në qoftë se nuk është e mundshme të bëhet shikimi i veshmbathjeve e sendeve të tjera personale, kurse në bazë të dëshmive të ofruara është konstatuar pa dyshim se ka ndodhur dëmtimi, shuma e të cilit nuk mund të konstatohet me siguri, të dëmtuarit pa e bërë shikimin e veshmbathjeve do t'i pranohet dëmi në shumën paushall, por jo më shumë se njëqind (100) euro për veshmbathje të sezonit të verës, përkatësisht dyqind (200) euro për veshje të sezonit dimërore.

Neni 29
Kompensimi për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes se përmendores

1. Shpenzime të varrimit konsiderohen shpenzimet që janë të domosdoshme, në përputhje me zakonet e vendit në të cilin do të bëhet varrimi.

2. Kompensimi për shpenzimet e varrimit caktohet në lartësinë e shpenzimeve të bëra sipas llogarive të vlefshme për çdo lloj të shpenzimit, që bashkë me kërkesën e paraqet personi që i ka mbuluar shpenzimet e varrimit.

3. Kompensimi i shpenzimeve të varrimit nuk mund të jetë më shumë se njëmijë e pesëqind (1,500) euro për varrimin e një personi.

4. Nëse vdekja ndodh në shtetin tjetër atëherë kërkohen edhe shpenzimet e bartjes së kufomës.

5. Kompensimi për shpenzimet e ngritjes së përmendores mbivarrë jepet atëherë kur përfituesi ta paraqesë faturat fiskale të punëtorisë së autorizuar zejtare, me të cilat vërtetohet se përmendorja mbivarrore është ndërtuar, si dhe kur të paraqesë fotografinë e përmendores së ndërtuar. Gjithashtu do të pranohet pagesa e kompensimit kur përfituesi ta paraqesë kontratën (marrëveshjen e lidhur) për ndërtimin e përmendores mbivarrë me të cilën mund të konstatohet se përmendorja mbivarrë është porositur.

6. Kompensimi për përmendoren caktohet në lartësinë e çmimit mesatar në vendin ku ngrihet përmendorja, por më së shumti deri në shumën një mijë (1,000) euro.

KREU V
DËMI JOMATERIAL

Neni 30
Dëmi jomaterial dhe format e tij

1. Format (kategoritë) e dëmit jomaterial, për të cilat mund të kërkohet dëmshpërblim, janë :
   a) dhembjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përhershëm jetësor;
   b) dhembjet fizike për shkak të lëndimeve trupore të pësuara;
   c) frika për shkak të lëndimeve të pësuara nga aksidenti për pasojat e mundshme ose për vdekjen, si dhe frika e intensitetit të lartë e përjetuar ose që do të përjetohet si rrjedhojë e aksidentit.
   d) dhembjet shpirtërore për shkak të dëmtimit të pamjes së jashtme (shëmtimit)
   e) dhembjet shpirtërore për shkak të vdekjes së personit të afërm (fëmijës, prindit, bashkëshortit).
   f) dhembjet shpirtërore për shkak të vdekjes së vëllezërve dhe motrave në rast se mes tyre dhe personit të vdekur në momentin e ndodhjes së aksidentit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.
   g) dhembjet shpirtërore për shkak të invaliditetit të rëndë të personit të afërm (bashkëshortit, prindit, fëmijëve)

Neni 31
Kompensimi për dhembjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor

1. Dhembjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktiviteteve të përgjithshme jetësore si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e trafikut, shprehin gjendjen shpirtërore (psikike) të aksidentuarit, për shkak të kufizimit ose të pamundësimit të ushtrimit të aktiviteteve të deriatëhershme jetësore, përkatësisht të aktiviteteve për të cilat mund të supozohet se do t'i ushtronte në të ardhmen, po mos të kishte ndodhur lëndimi.

2. Kompensimi për dhembjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktiviteteve të përgjithshme jetësore, që i ka përjetuar i aksidentuari, që i përjeton aktualisht dhe që do t'i përjetojë në të ardhmen, ka karakter të kompensimit në të holla për pasojat (mundimet), që paraqiten në përpjekje të sforcuara fizike me rastin e ushtrimit të aktiviteteve themelore të rëndomta jetësore dhe në shkurtimin e disa kënaqësive dhe gëzimeve, nga të cilat është

privuar për shkak të lëndimeve të marra dhe për të cilat mund të supozohet me siguri se i aksidentuari do t'i ushtronte në të ardhmen.

3. Lartësia e kompensimit varet nga lloji i lëndimeve, nga pjesa e trupit që u është ekspozuar lëndimeve, nga mosha e të lënduarit dhe nga përqindja e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.

4. Përqindja e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor caktohet nga mjeku censor apo mjeku në cilësinë e ekspertit (institucionit përkatës- p.sh Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) përkatësisht, në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe vizitës së drejtpërdrejtë të të lënduarit, në përputhje me ***"tabela e përcaktimit të përqindjes së zvogëlimit të aktivitetit jetësor"***, (shtojca 1 dhe shtojca 2).

5. Lartësia e kompensimit caktohet në atë mënyrë që për çdo përqindje të zvogëlimit të aktivitetit jetësor varësisht nga vitet e të lënduarit jepen:
   a) deri në moshën 30-vjeçare.....treqind (300) euro;
   b) nga mosha 31 deri tek ajo 50-vjeçare.....dyqind e pesëdhjetë (250) euro;
   c) nga mosha 51 deri tek ajo 70-vjeçare.....dyqind (200) euro;
   d) dhe përtej moshës 70-vjeçare.....njëqind e shtatëdhjetë (170) euro;

Neni 32
Kompensimi për dhembjet trupore

1. Kompensimi për dhimbjet trupore – fizike pranohet deri në ditën kur ato ndërpriten, e më së largu deri në përfundimin e mjekimit.

2. Dhembjet fizike që paraqiten për shkak të lëndimeve trupore të pësuara në aksident shprehen në forma të ndjenjës, që e përjeton dhe e duron personi në gjendje të vetëdijshme kur i shkaktohen lëndimet trupore:
   a) për dhembjet fizike të shkaktuara nga lëndimet e pësuara nga aksidenti, të cilat kanë lënë tek i aksidentuari pasoja të përhershme, të shprehura në zvogëlimin e aktivitetit jetësor mbi 30% dhe atë:
      i. për dhimbjet me intensitet posaçërisht të rëndë dyqind (200) euro për orë, por me limit gjer në njëmijë (1,000) euro në total,
      ii. për dhimbjet me intensitet të rëndë, deri në njëqind e pesëdhjetë (150) euro, për një ditë, por me limit gjer në shtatëqind e pesëdhjetë (750) euro në total,
      iii. për dhimbjet me intensitet të mesëm, prej shtatëdhjetë e pesë (75) euro, në ditë por me limit gjer në tremijë e shtatëqind e pesëdhjetë (3,750) euro në total.
      iv. Për të gjitha këto forma të dëmit për dhimbje fizike, limiti maksimal nuk mund ta kalojë shumën mbi pesëmijë e pesëqind (5,500) euro në total.

b) Për dhembjet fizike të shkaktuara nga lëndimet e pësuara si pasojë e aksidentit, të cilat kanë lënë tek i aksidentuari pasoja të përhershme, të shprehura në zvogëlimin e aktivitetit jetësor nën 30% dhe atë:
   i. për dhimbjet me intensitet posaçërisht të rëndë deri në njëqind (100) euro për orë, por me limit gjer në pesëqind (500) euro në total,
   ii. për dhimbjet me intensitet të rëndë, deri në pesëdhjetë (50) euro për një ditë, por me limit gjer në dyqind e pesëdhjetë (250) euro në total,
   iii. për dhimbjet me intensitet të mesëm, deri në tridhjetë (30) euro në ditë, por me limit gjer në njëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë (1,750) euro në total.
   iv. Për të gjitha këto forma të forma të dëmit për dhimbje fizike, limiti maksimal nuk mund ta kalojë shumën mbi dymijë e pesëqind (2,500) euro në total.

c) Për dëmtimet të kategorizuara në lëndime të lehta trupore:
   i. Për dhimbjet fizike të lehta trupore, limiti maksimal nuk mund ta kalojë shumën mbi treqind e pesëdhjetë (350) euro në total.

Neni 33
Kompensimi për frikën

1. Kompensimi për pasojat që lë frika tek i aksidentuari përcaktohet varësisht nga intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës.
   a) **Frika parësore** është ndjenja intensive me kohëzgjatje të shkurtër (disa sekonda), që shfaqet, perceptohet dhe përjetohet nga personi i aksidentuar në momentin e aksidentit.
   b) **Frika dytësore** është ndjenjë që e përjeton personi i aksidentuar nga aksidenti i trafikut dhe pas aksidentit, lëndimeve të marra dhe e lidhur me ecurinë e mjekimit, si dhe me pasojat e mundshme.

2. Intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës e cakton mjeku kompetent, në bazë të dokumentacionit të verifikuar mjekësor për mjekimin e të lënduarit dhe të ekzaminimit të drejtpërdrejtë.

3. Kompensimi për **Frikën parësore dhe Frikën dytësore** caktohet në proporcion të 70% të vlerës së dedikuar për dhembje fizike, me përjashtim në raste të veçanta sidomos te fëmijët dhe gratë shtatzëna të involvuar në aksident të cilët edhe pa pësuar lëndime dhe dhimbje mund të përjetojnë frikë.

4. Frika primare dhe sekondare për persona me lëndime të lehta trupore nuk mund të caktohet mbi shumën treqind (300) euro.

5. Në rastet kur raportet mjekësore janë pa diagnoza, pa përshkrime të lëndimeve apo vetëm me përshkrim të ankesave subjektive në proporcion me dëmin e shkaktuar në automjet, frika mund të caktohet deri në shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) euro.

Neni 34
Kompensimi për dhembje shpirtërore për shkak të shëmtimit (dëmit estetik)

1. Kompensimi për dhembje shpirtërore për shkak të shëmtimit jepet për të kompensuar vuajtjet që përjeton i lënduari për shkak të ndryshimeve të paripërueshme të ndodhura si pasojë e aksidentit, dëmtime të paraqitura në fytyrën e ndryshuar, që nuk mund të përmirësohet me çfarëdo lloj ndërhyrjeje kirurgjike (operacione plastike), të ndryshimeve trupore (shtrembërimi, paraliza e pjesëve të caktuara të trupit, shkurtimi ose humbje e ndonjë pjese të trupit) që nuk është e mundshme të mënjanohen dhe që janë shumë të dukshme, si edhe të ndryshimeve në trup që janë të dukshme në raste të caktuara (në plazhe e në pishina, gjatë ushtrimit të aktiviteteve sportive dhe në situata të ndryshme, në të cilat i lënduari ua ekspozon pjesët e lënduara të trupit shikimeve të të pranishmëve).

2. Lartësia e kompensimit përcaktohet në varësi të shkallës së shëmtimit, të gjinisë dhe moshës së të lënduarit, të cilën e përcakton mjeku censor në bazë të kontrollimit të të lënduarit dhe të dokumentacionit burimor mjekësor për lëndimet e marra dhe ecurinë e mjekimit të tyre. Lartësia e kompensimi për dhembjet shpirtërore për shkak të shëmtimit.

3. Shkallën e shëmtimit e përcakton mjeku – censori në bazë të kontrollimit të të lënduarit dhe të dokumentacionit mjekësor për lëndimet e marra dhe ecurinë e mjekimit të tyre.

4. Lartësia e kompensimit përcaktohet në bazë të shkallës së shëmtimit, varësisht nga gjinia dhe mosha e të lënduarit, në këtë mënyrë:
   a) për shkallën e lartë të shëmtimit .....prej dymijë (2,000) deri në pesëmijë (5,000) euro
   b) për shkallën e mesme të shëmtimit.....prej pesëqind (500) deri në dymijë (2,000) euro
   c) për shkallën e ultë të shëmtimit .....deri në pesëqind (500) euro

5. Në raste të veçanta, për shkallën jashtëzakonisht të lartë (amputime, paraplegji etj.) – pesëmijë (5,000) deri në shtatëmijë (7,000) euro.

Neni 35
Kompensimi për dhembje shpirtërore për shkak të vdekjes ose invaliditetit tepër të rëndë të personit të afërm

1. Dhembja shpirtërore për shkak të vdekjes ose të invaliditetit tepër të rëndë të personit të afërm është ndjenjë subjektive, që manifestohet si çrregullim i gjendjes psikike, i vuajtjes, i pikëllimit dhe i dhembjes, si edhe për rastet kur është e ditur se ndjenjat ose çrregullimet e këtilla do të ndodhnin në të ardhmen për shkak se do të dihet për vdekjen, ose për invaliditetin tepër të rëndë të personit të afërt që e ndrydh psikikën dhe paraqitësit e kërkesës.

